

Komunikatë për shtyp

Pas shpërthimit të pandemisë të përmasave globale, rajoni i Ballkanit Perëndimor po kërkon gjithashtu të gjejë (miratojë) një strategji adekuate për të kontrolluar përhapjen e virusit COVID-19 dhe në këtë mënyrë të ruajë stabilitetin dhe funksionalitetin e sistemeve ekzistuese shëndetësore. Caktimi i parimeve të qarta për menaxhimin e krizave në situata të jashtëzakonshme dhe futjes graduale të masave mbrojtëse për të mbrojtur popullsinë nga epidemia e një shkalle të gjerë duhet të jetë një prioritet kryesor i Qeverisë së Kosovës në luftën kundër virusit të tmerrshëm. Sidoqoftë, rreziku i një përhapjeje të mëtejshme të virusit po bëhet një kërcënim gjithnjë e më i rrezikshëm që, në vend të ndarjes, kërkon një qasje të përbashkët dhe bashkëpunim të ndërsjellë për të luftuar këtë epidemi. Sidoqoftë, në rrethanat komplekse që mbizotërojnë në Kosovë, në vend që të jetë mbikombëtarë, Covid-19 vepron shpesh si një virus monokombëtarë, sepse për shkak të mungesës së përkthimit zyrtar, njoftimet zyrtare nga Qeveria e Kosovës arrijnë tek komuniteti serb në Kosovë me vonesa të konsiderueshme. Gjithashtu, informacione të rëndësishme për korona virusin u dërgohen parapaguesve të telefonisë mobile ekskluzivisht në gjuhën shqipe. Konfuzioni shtesë krijohet edhe nga mungesa e vendimeve të qarta në lidhje me hyrjen dhe daljen nga Kosova, njohjen e dokumenteve personale, ku gjithashtu duhet të shtohet edhe qëndrimi i personave që hyjnë në Kosovë në karantinë, përfshirë lëvizjen brenda vetë Kosovës, për të cilën gjë komuniteti serb nuk është i njoftuar mjaftueshëm. Për shkak të paqartësive të shumta, është i rrezikuar furnizimi me pajisje mbrojtëse i qendrave të kujdesit shëndetësor dhe barnatoreve, të tilla si maska mbrojtëse, doreza, dezinfektues, të cilat sot pothuajse mungojnë në treg, dhe pa të cilat shumëfishohet niveli i rrezikut të popullsisë. Në kushtet e bashkëpunimit minimal, por në shumë raste joekzistent, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe qendrave mjekësore në komunitetet me shumicë serbe, është e diskutueshme se sa jemi në të vërtetë të përgatitur për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate luftimit të pandemisë.

Kjo është vetëm një pjesë e problemeve me të cilat po përballet komuniteti serb sot dhe, pa asnjë dyshim, kërkon një qasje institucionale të ndryshme nga ajo aktuale. Kujtojmë që në gjendje të jashtëzakonshme, komunikimi i drejtpërdrejtë i zyrtarëve dhe trajtimi i barabartë i të gjitha mediave është jetësorë për informimin e të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë. Një qasje e tillë ul ndjeshëm rrezikun e përhapjes së dezinformatave dhe panikut përmes rrjeteve sociale, ndaj të cilave publiku është i ekspozuar vazhdimisht këto ditë.

Sidoqoftë, shtrohet edhe pyetja - a është kjo qasje mënyra e duhur për të luftuar sëmundjen e tmerrshme vdekjeprurëse të Shekullit 21, ku sukcesi në luftën kundër një pandemie varet vetëm nga bashkëpunimi i ndërsjellë, qasja e plotë në informacione me rëndësi publike dhe

ngritja e vetëdijes të secilit individ, pavarësisht përkatësisë etnike, për rëndësinë e respektimit të masave të marra për të luftuar Covid 19? Pse, edhe në rrethana të tilla të jashtëzakonshme, duhet përsëri të rikujtojmë institucionet dhe publikun e gjerë për të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe ligj?

Për të mos lënë shumë nga këto pyetje pa përgjigje dhe banorët, veçanërisht të komuniteti serb, pa informata të duhura, ne u bëjmë thirrje institucioneve kompetente të Qeverisë së Kosovës të veprojnë si në vijim:

1. Të miratojnë parime të qarta të komunikimit me popullsinë jo shumicë, duke respektuar dispozitat kushtetuese dhe ligjore në lidhje me përdorimin e gjuhës serbe si një nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Në të njëjtën kohë, të gjitha njoftimet dhe vendimet me shkrim duhet të jenë njëkohësisht të qasshme për media/publikun e gjerë në të dy gjuhët zyrtare, dhe konferencat për shtyp të organizuara me përkthim simultan;
2. Të vendosin një komunikim të dyanshëm me qendrat shëndetësore në komunitetet me shumicë serbe në mënyrë që, mbi të gjitha, të shkëmbejnë informacion çdo ditë mbi statusin e pacientëve të infektuar dhe të përkujdesur, dhe të informojnë rregullisht publikun në të gjitha komunitetet e Kosovës;
3. Konsiderojmë që krijimi i një fronti më të fuqishëm është një prioritet kyç në luftën kundër virusit COVID-19, dhe për këtë arsye ju bëjmë thirrje të dy qeverive, në Kosovë dhe Serbi, të miratojnë parimet e fleksibilitetit funksional dhe kështu të mundësojnë lëvizjen e lirë të punëtorëve shëndetësorë brenda dhe jashtë Kosovës;
4. Një qasje e tillë rrit aftësinë e punëtorëve të kujdesit shëndetësor për të siguruar trajtimin e duhur për pacientët që kërkojnë trajtim në qendrat e specializuara shëndetësore.
5. Qeveria duhet të ndryshojë dhe plotësoj ueb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë <https://kosova.health/sr> në gjuhën serbe dhe ta plotësojë atë me gjuhët e komuniteteve të tjera jo-shumicë në Kosovë, përfshirë të gjitha informacionet përkatëse për situatën aktuale në lidhje me virusin COVID-19 me vendimet e Qeverisë, si dhe me numra të rëndësishëm të institucioneve të kujdesit shëndetësor në rajone të ndryshme të Kosovës, ku mund të drejtohen njerëzit e sëmurë;
6. Për të zvogëluar përhapjen e dezinformatave, ne sugjerojmë zhvillimin e aplikacioneve për telefona mobil për platformat Android dhe IOS që do të përmbajnë informacion identik të postuar në faqe <https://kosova.health/sr>;
7. Ne u bëjmë thirrje operatorëve kryesorë mobilë në Kosovë (VALA, IPKO) të sigurojnë informacion të rregullt publik për banorët në përputhje me gjuhët zyrtare në Kosovë;
8. Të përmirësohet komunikimi dhe aktivitetet me popullsitë jo-shumicë duke përfshirë grupet më të rrezikuara të popullsisë në këtë situatë, kryesisht rastet sociale, personat e zhvendosur brenda vendit në qendrat kolektive dhe personat me aftësi të kufizuara.

25 mars 2020

Anëtarët e Empirikës

Aktiv, Qendra për Përfaqësimin e Kulturës Demokratike – ACDC, Qendra për të drejtat e komuniteteve jo shumicë – EMEG, Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik – FDMC, Gračanica Online, Qendra humane (Humani centar), Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë – CSD, New Press, Radio Kontakt Plus, RTV Kim, RTV Mir, Sinergija.